



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipality of Kačanik

## Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

03 Nr. 104/02-7834/26  
Kaçanik, 03.04.2026

Duke u bazuar në Nenin 12 të Rregullores Nr.04/2017 mbi Kriteret , Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në komunën e Kaçanikut bënë:

**Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve , programi i punës i të cilave është i fokusuar në zhvillimin e aktiviteteve këshilluese, avokuese dhe ofrimin e drejtëpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare.**

1. Komuna e Kaçanikut – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale fton të gjitha Organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, me bazë në komunën e Kaçanikut, për aplikim për mbështetje financiare – subvencionim të tyre, programi i punës i të cilave është i fokusuar në zhvillimin e aktiviteteve këshilluese, avokuese dhe ofrimin e drejtëpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projektet e tyre të cilat duhet të kenë për objekt zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, respektivisht të ushtrojnë aktivitete që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe këshilluese për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 4,000.00€.
4. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të aplikohet për çdo projekt individual është 1,000.00€, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 4,000.00€.
5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve (aplikacioneve) është 15(pesëmbëdhjetë) ditë pune. Afati për dorëzimin e dokumentacionit fillon me datë 06.04.2026 dhe përfundon me datë 24.04.2026.

Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të të cilat janë të regjistruara në regjistrin e Organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes. Po ashtu OJQ-të duhet të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqes prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menagjeri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e palikueshme.

6. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët janë në dispozicion në webfaqen e komunës së Kaçanikut, siç është:  
<https://kacanik.rks-gov.net/shpalljet/>

Kërkesës së aplikimit duhet t'i bashkangjiten edhe dokumentet:

1. Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit të OJQ-së dhe menaxherit të projektit
2. Formulari i projekt-buxhetit
3. Formulari i deklaratës së partneritetit;
4. Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
5. Kopja e certifikatës së numrit fiskal;
6. Forma e deklaratës të mungesës së financimit të dyfisht;
7. Forma e deklarimit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit;
8. Deklaratë e dorëzimit të pasqyrave financiare;
9. Çertifikatë nga ATK në lidhje me gjendjen e borxhit publik të aplikuesit.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen tek:

**Objekti i komunës ,kati përdhese, sporteli nr.8.**

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet të cilat janë pranuar brenda afatit të paraparë në thirrje publike dhe të cilat përmbushin kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Drejtoreshë e DSHMS-së  
Lumije Selmanaj-Demnika

